



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201401382/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur shtetase E.D. duke e pranuar në Shkollën Bazë të Policisë.*

**Drejtuar :** **Ministrit të Punëve të Brendshme**  
**Z. Saimir TAHIRI**

**Tiranë**

***I nderuar zoti Ministër,***

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja E.D.. Ankuesja shkruan se, gjatë vitit 2014 ka aplikuar dhe ka konkuruar për në Shkollën e Bazë të Policisë së Shtetit. Në përfundim të testimit intelektual dhe fizik është shpallur fituese, duke u renditur e 209 në listën përfundimtare të fituesve. Në datën 01.07.2014 ajo është paraqitur në Akademinë e Policisë për të filluar shkollën. Kur është paraqitur në shkollë është njoftuar se duhet të kryente ritestimin fizik. Pas ritestimit fizik ajo është skualifikuar dhe nuk është pranuar në shkollë. Ankuesja pretendon se, ka kërkuar shpjegime për procedurën dhe bazën ligjore të ritestimit fizik, por nuk i janë dhënë shpjegime. Këtë qëndrim të mbajtur ndaj saj, duke e futur në ritestim fizik dhe më pas skualifikuar nga e drejta për t'u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë, ajo e konsideron të padrejtë, diskriminues dhe cënim të të drejtës kushtetuese të barazisë së shtetasve para ligjit.

Në bazë të kërkesës tonë drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 1226/2 Prot., datë 27.11.2014 ndërmjet të tjerave na informoi se, aplikantia E.D. ka konkuruar për në Shkollën Bazë të Policisë dhe në përfundim të testimit është renditur e 209 në listën përfundimtare prej 500 fituesish. Pas shpalljes së listës përfundimtare, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë u bënë mbi 100 ankesa nga aplikantët që nuk ishin në listën fituese.

Bazuar në nenin 13, pika 3, gërma "b" dhe nenin 20 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", në numrin e madh të ankesave të aplikantëve të shpallur jo fitues dhe rekomandimin e Drejtorisë së Standardeve Profesionale drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 996,

datë 17.07.2014, me qëllim verifikimin e rezultateve të arritura gjatë testimit të aftësive fizike për disa aplikantë, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 959, datë 30.06.2014 "Për komisionet dhe procedurat e ritestimit fizik të aplikantëve", që kanë aplikuar për në Shkollën Bazë të Policisë, "Patrullë e përgjithshme", më datë 02.07.2014 janë marrë në ritestim fizik gjithsej 27 alikantë të renditur fitues, nga këta 14 meshkuj dhe 13 femra.

Nga ritestimi fizik rezultoi se, aplikantia E.D. ka marrë pjesë në 1 garë nga 5 të planifikuara për ritestim, sepse në garën e kërcimit së larti norma e kërcimit është 16.5 "inc" e barabartë me 36 cm, ndërsa aplikantia ka kërcyer 32 cm. Sipas rregullores së testimit, nëse skualifikohesh në një garë nuk ke të drejtë të konkurosh më në garat e tjera dhe për këtë arsye ajo është e skualifikuar. Gjithashtu gjatë këtij ritestimi janë skualifikuar edhe kandidatë të tjerë femra e meshkuj.

Nga shqyrtimi i akteve normative në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit rezulton se, e drejta e një personi për t'u pranuar në Polici është parashikuar në aktet normative të mëposhtme që kanë qënë në fuqi në kohën e konkurimit:

1. Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", respektivisht në nenin 49 të tij. Sipas këtij neni, *"Ka të drejtë të konkurojë për t'u pranuar si punonjës policie çdo person që plotëson kriteret e mëposhtme:*

- a) është shtetas i Republikës së Shqipërisë;*
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;*
- c) është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;*
- ç) ka mbaruar shkollën e mesme;*
- d) jep informacionin e kërkuar në lidhje me punën e tij të mëparshme ose ndonjë çështje tjetër që lidhet me pranimin e tij në shërbimin policor;*
- dh) nuk është dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;*
- e) ka dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B."*

2. "Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit", e cila është miratuar me VKM nr. 804, datë 21.11.2007, respektivisht në nenet 4 deri 27 të saj, ku parashikohet në mënyrë të detajuar pranimi në Polici, kriteret, dokumentat, procedura e aplikimit dhe ajo e testimit.

Ndërsa testimi i aftësive fizike dhe kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike parashikohet në nenet 15 e 16 të kësaj rregulloreje.

Në nenin 15, të saj parashikohet se:

*"1. Aplikantët, që kalojnë testin me shkrim, duhet të kalojnë testin e aftësive fizike, që teston aftësitë psikomotore, ku përfshihet: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të policisë.*

*2. Testi i aftësive fizike vlerësohet sipas standardit të përcaktuar në kohën e zhvillimit të testit. Përmbajtja e testit të aftësive fizike, si dhe standardi i përcaktuar për kalimin e tij përfshihen në udhëzuesin për aplikim.*

Ndërsa në nenin 16 të saj parashikohet se:

*"1. Kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike janë si më poshtë:*

a) kandidati duhet të përfundojë të gjitha ushtrimet brenda kohës së caktuar;

b) kandidati duhet t'i kalojë të gjitha fazat në rendin e kërkuar.

2. Pas përfundimit të testit, kandidatit i bëhet i ditur rezultati dhe, nëse ka kaluar njoftohet për të vazhduar procesin e testimit.

Sikurse rezulton nga përmbajtja e këtyre dy akteve normative dhe veçanërisht nga dispozitat e "Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit" të cituara më lartë, në asnjërën prej pikave dhe gjërave të tyre, por jo vetëm, nuk parashikohet si kriter pranueshmërie ritestimi fizik i aplikantit që ka konkuruar për në Shkollën Bazë të Policisë. Gjithashtu edhe nga përmbajtja e neneve 24 e 25 të "Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit", ku parashikohen rastet për skualifikim të menjëhershëm dhe për skualifikim të mundshëm të aplikantit, nuk parashikohet skualifikimi i kandidatit për shkak se nuk kalon ritestimin fizik, që refuzon kryerjen e tij, apo për shkak se janë bërë shumë ankesa nga aplikantët jo fitues.

Ndërkohë është me rëndësi që të theksojmë se, në asnjë dispozitë të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe të "Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit", miratuar me VKM nr. 804, datë 21.11.2007, nuk është parashikuar e drejta e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të nxjerrë urdhra për vendosjen apo për caktimin e kritereve të pranimit për në Shkollën Bazë të Policisë, jashtë atyre të parashikuara në këto dy akte normative.

Për këto arsye, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 959, datë 30.06.2014 "Për komisionet dhe procedurat e ritestimit fizik të aplikantëve", që kanë aplikuar për në Shkollën Bazë të Policisë, "Patrullë e përgjithshme", është i pabazuar, sepse është nxjerrë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 118 të Kushtetutës i cili parashikon se:

*"1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.*

*2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*

*3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër".*

Për këto arsye, duke iu referuar Kodit të Procedurave Administrative, respektivisht neneve 115/a dhe 116/c rezulton se, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 959, datë 30.06.2014 "Për komisionet dhe procedurat e ritestimit fizik të aplikantëve", që kanë aplikuar për në Shkollën Bazë të Policisë, "Patrullë e përgjithshme", është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Ju bëjmë me dije se, referuar nenit 117/1 të Kodit të Procedurave Administrative, ***ky akt administrativ (urdhër) nuk prodhon pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar apo jo si absolutisht i pavlefshëm.***

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, të përgjigjes së dërguar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të

Policisë së Shtetit dhe referimit të aktet normative të cituara më lartë arritëm në konkluzionin se, *ritestimi fizik dhe skualifikimi i aplikantes E.D. nga e drejta për t'u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë është i pabazuar në ligj dhe në kundërshtim të plotë e të hapur me dispozitat e akteve normative të përshkruara më sipër.* Ndërkohë ky qëndrim përbën shkelje të drejtës kushtetuese të barazisë para ligjit të çdo qytetari të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, si dhe nga dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të “Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit”, miratuar me VKM nr. 804, datë 21.11.2007. Gjithashtu ritestimi i ankueses për shkak të moshës dhe skualifikimi i saj nga e drejta për t'u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë përbën një formë diskriminimi.

Për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur ankueses, me shkresën nr. K2/E23-5 Prot., datë 14.01.2015 i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit *marrjen e masave të nevojshme për bërë të mundur pranimin e aplikantes E.D. në Shkollën Bazë të Policisë.*

Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 89/1 Prot., datë 30.01.2015, ndërmjet të tjerave na informoi se, rekomandimi ynë nuk është pranuar dhe ndërkohë sugjeron që nëse ankuesja dëshiron të vazhdoj shkollën le të konkuroj përsëri kur të hapet procesi i ri i konkurimit.

Qëndrimin e mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në trajtimin e këtij rasti duke e skualifikuar padrejtësisht ankuesen nga e drejta për t'u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë dhe refuzimin e rekomandimit të institucionit tonë i konsiderojmë të padrejta dhe të pabazuara në ligj. Sikurse është argumentuar më sipër, ritestimi fizik i aplikantëve nuk është i bazuar në aktet normative dhe nuk është kriter për t'u pranuar apo skualifikuar nga pranimi në Shkollën Bazë të Policisë.

Ndërkohë ju sjellim në vëmendje se, për dy raste të tjera ankesash të të njëjtës natyrë, skualifikim të aplikantëve për shkak të ritestimit fizik, është mbajtur qëndrim i ndryshëm dhe i drejtë, që në fazën e kërkesës tonë për shpjegime. Këto raste i përkasin shtetasve V.G. dhe B.D., për të cilët Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresat respektivisht, për të parin me nr. 37/1-V Prot., datë 21.01.2015 dhe për të dytën me nr. 7929/1 Prot., datë 26.12.2014 na ka informuar se ankesat e tyre janë zgjidhur pozitivisht dhe ata janë pranuar në listën e fituesve dhe në Shkollën Bazë të Policisë.

Sikurse rezulton e provuar plotësisht, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është mbajtur qëndrim me dy standarde për persona të ndryshëm në trajtimin e të njëjtës çështjeje dhe gjatë të njëjtit proces aplikimi të konkurentëve në vitin 2014.

Përsa më sipër dhe në cilësinë e organit epror, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen*”,

## **REKOMANDOJMË:**

Ushtrimin e kompetencave Tuaja ligjore si organ epror për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur të shtetases E.D. duke e pranuar në Shkollën Bazë të Policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi që të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**